



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 956/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Hasan Maxhuni, kandidat për asamble komunale nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Vushtri, paraqitur kundër komisionarëve të vendotimeve, për shkak të parregullsive për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 26.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHEN poshtë si të palejuara ankesat e Hasan Maxhunit nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Vushtri

Arsyetim

PZAP, më datë 25.11.2013, ka pranuar ankesat: Anr. 956/2013, dhe Anr. 957/2013 nga Hasan Maxhuni nga subjekti politik AAK dega Vushtri, me të cilat pretendohet se:

- Në ankesën Anr. 956/2013 parashtruesi i ankesës dyshon se në vendvotimin 2706B ka pasur vota, por se votat i mungojnë dhe se për këtë dyshon në komisionarët e këtij vendvotimi pasi që vota u janë devijuar kah anëtarët e afërt të këtyre komisionerëve. Andaj parashtruesi i ankesës kërkon që të kontrollohet vendvotimi 2706B
- Në ankesën Anr. 957/2013, parashtruesi i ankesës thekson se ai dyshon se në vendvotimin 2708B/01R,02R dhe 03D ka pasur vota por se komisionarët e këtyre vendvotimeve i kanë treguar se janë prishur mbi 106 vota. Parashtruesi i ankesës kërkon që të kontrollohet ky vendvotim pasi që ai është i bindur se në këtë vendvotim ka qenë i votuar dhe se dyshimin për mungesën e votave e ka të komisionarët e këtyre vendvotimeve.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pasi shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të palejuara

PZAP-i, konstatoi se ankesat janë të palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment.

Ankesat në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrahet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së i cili parashihet “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me këtë ligj”. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtror ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parashihet se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të katër rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 956/2013 më datën 26.11.2013



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.